

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Shukri Sylejmani, kryetar, Erdogan Haxhibeqiri dhe Emine Kaçiku, anëtarë, në çështjen juridike të paditëses M. H., nga Ferizaj, të cilën e përfaqëson V. B., avokate në Prishtinë, kundër të paditurës K. e S. “S. U. G.”-Austria, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson A. N., sipas autorizimit me shkrim, për shkak të dëmshpërblimit, duke vendosur lidhur me revizionin e të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë CA.nr.224/2014 datë 30.08.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 15.11.2017, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Aprovohet pjesërisht si i bazuar revizioni i të paditurës, dhe ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në Prishtinë CA.nr.224/2014 datë 30.08.2017, dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj C.nr.117/2010 datë 12.11.2013, në pjesën e dispozitivit ku është gjykuar kompensimi në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, ushqimit të përforcuar dhe fitimit të humbur në emër të zvogëlimit të aftësisë punuese, ashtu që:

Obligohet e paditura që paditëses në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor prej 25% t'i paguajë shumën prej 7.500,00 €, dhe për ushqim të përforcuar për 2 muaj shumën prej 400 €. Ndërsa në emër të fitimit të humbur për zvogëlim të aftësisë punuese, e paditura obligohet që paditëses t'i paguajë për muajin shkurt 2010 shumën prej 246 €, për muajin mars dhe prill nga 300 € në muaj, ndërsa për muajin maj, qershor dhe korrik nga 150 € në muaj, dhe duke filluar që nga muaji gusht 2010, e tutje gjersa për këtë të ekzistojnë kushtet ligjor nga 75 € në muaj, me kamatë të cilën e paguajnë bankat në Kosovë si për deponimet në kursim me afat mbi 1 vit e pa destinim të përcaktuar, duke filluar që nga data 01 e çdo muaji në vijim, si ditë e arritjes për pagesë të kështit nga muaji i kaluar, e deri në pagesën definitive.

Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurës përkitazi me kompensimin e gjykuar me aktgjykimet e lartpërmendura, në emër të dhimbjeve fizike, frikës dhe ndihmës së personit të tretë.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj C.nr.117/2010 datë 12.11.2013, është aprovuar pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditëses, ashtu që është detyruar e paditura që paditëses t'i paguajë për dhimbje fizike shumë prej 3.500 €, në emër të frikës së përjetuar shumë prej 2.500 €, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumë prej 14.000 €, në emër të fitimit të humbur për shkak të zvogëlimit të aftësisë punuese, shumë e kapitalizuar prej 20.026.50 €, në emër të ndihmës nga personi i tretë shumë prej 450 €, dhe në emër të ushqimit të përforcuar shumë prej 600 €, apo shumë e përgjithshme prej 42.076,00 €, me kamatë të cilën e paguajnë bankat si për deponimet në kursim me afat për 1 vit, duke filluar nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën përfundimtare, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 2.464 €, ndërsa përtej shumave të gjykuara , kërkesëpadia e paditëses është refuzuar si e pabazuar.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë CA.nr.224/2014 datë 30.08.2017, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditëses, ndërsa ankesa e të paditurës është aprovuar pjesërisht si e bazuar, dhe është ndryshuar aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë , ashtu që e paditura është obliguar që paditëses në emër të dhimbjeve fizike t'i paguajë shumë prej 3.000 €, për frikë shumë prej 2.000 €, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm shumë prej 9.000 €, për fitim të humbur në emër të zvogëlimit të aftësisë punuese shumë e kapitalizuar prej 5.552,17 €, ndërsa përkitazi me kompensimin e gjykuar në emër të ndihmës së personit të tretë dhe ushqimit të përforcuar, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është vërtetuar.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, e paditura me kohë ka paraqitur revizion duke mos cekur bazat e paraqitjes së revizionit të parapara në nenin 214 të LPK, por me pretendim se gjendja faktike është vërtetuar gabimisht dhe për pasojë aktgjykimi i kundërshtuar përfshihet me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për çka ka propozuar që të ndryshohen të dy aktgjykimet e lartpërmendura ashtu që kërkesëpadia e paditëses të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, edhe pse e paditura nuk ka cekur bazat e paraqitjes së revizionit, shqyrtoi aktgjykimin e goditur me revizion në kuptim të nenit 215 të Ligjit për Procedurë Kontestimore (LPK), dhe gjeti se:

Revizioni i të paditurës pjesërisht është i bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se sipas aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Komonale në Prishtinë P.nr.2049/2010 datë 28.06.2011, në Rrugën Magjistrale Mitrovicë-

Prishtinë, në Milloshevë, I. B. nga Kaqaniku me banim në Ferizaj, ka shkaktuar aksident komunikacioni më datën 06.02.2010, në atë mënyrë që duke drejtuar automjetin e markës “VW Jetta”, me targa regjistrimi ..., të siguar tek e paditura , nuk ka respektuar kufizimin e shpejtësisë së lëvizjes dhe të përshtatjes së saj gjendjes në rrugë dhe kushteve të komunikacionit, dhe me atë rast ka humbur kontrollin e drejtimit të këtij automjeti. Padiësja duke u gjendur në këtë automjet si bashkudhëtare, për shkak të drejtimit të kundërligjshëm të këtij automjeti, ka pësuar lëndime të rënda trupore, të cilat sipas ekspertëve mjekësor dr.T. G., specialist i mjekësisë ligjore, dr.V. B., ortoped-traumatolog dhe dr.F. D., neuropsikiatër, manifestohen si thyerje kompresive (shtypëse) të unazës ijore L1, mbretje (kontuzion) në zonën ijore (lumbale) dhe lezion (dëmtim) i rrënjëve të nervave në mes të unazave L2-L3 dhe L4-L5, si pasojë e të cilave padiësja ka përjetuar dhimbje fizike dhe frikë me intensitet dhe kohëzgjatje të ndryshme, zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor prej 25% për shkak të zvogëlimit të lëvizjes së pjesës ijore të boshtit kurrizor të shkallës së mesme , dhe zvogëlim të aftësisë punuese në lartësi për 100% gjatë 3 muajve të parë pas aksidentit , e pastaj edhe për 3 muaj tjerë në vazhdim në lartësi prej 50%, ndërsa pas 6 muajve prej ditës së aksidentit ky zvogëlim i aftësisë punuese tek padiësja manifestohet në lartësi prej 25%, për shkak se padiësja me profesion si ekonomiste, ka probleme të mëtejshme me dhembjet në pjesën ijore dhe sidomos në këmbën e djathtë kur qëndron gjatë në pozitën ulur. Padiësja ka pasur nevojë për ndihmën e personit të tretë, 3 muaj ndërsa për ushqim të përforcuar 2 muaj.

Në këtë gjendje faktike të vërtetuar kësisoj , gjykata e shkallës së parë pasi që ka gjetur se me fajin e të siguarit të paditurës , padiësja ka pësuar lëndime të rënda trupore , dhe për pasojë të këtyre lëndimeve ka pësuar dhimbje fizike , frikë dhe forma tjera të dëmit material dhe jo material, duke u bazuar edhe në moshën e padiësës e cila është e lindur më datën 20.11.1980, dhe kriteret tjera relevante për caktimin e një dëmshpërblimi real , padiësës i ka gjykuar një dëmshpërblim, të përshkruar më afër si në dispozitivin e aktgjykimit të saj.

Gjykata e shkallës së dytë, në procedurë ankimore , ka refuzuar ankesën e padiësës, ndërsa ankesën e të paditurës e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar, ashtu që dëmshpërblimin e gjykuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë pjesërisht e ka zvogëluar, dhe atë për dhimbje fizike , frikë, zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe fitim të humbur për zvogëlim të aftësisë punuese, në tërësi si në dispozitivin e aktgjykimit të saj, ndërsa përkitazi me kompensimin e gjykuar për ndihmë të personit të tretë dhe ushqim të përforcuar, ka vërtetuar të njëjtin aktgjykim duke pranuar si të bazuara të gjitha konstatimet faktike dhe juridike të së njëjtës gjykatë.

Në një gjendje të tillë faktike, Gjykata Supreme e Kosovës gjen se ligjërisht është i pranueshëm qëndrimi juridik i gjykatave të shkallës më të ulët lidhur me caktimin e dëmshpërblimit real për paditësen, mirëpo Gjykata Supreme vlerëson se shuma e aprovuar në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe ushqimit të përforcuar është pakëz e lartë, dhe si e tillë është në kundërshtim me kriteret ligjore për caktimin e një dëmshpërblimi të tillë të parapara në nenin 200 par.2 të LMD, dhe me praktikën gjyqësore të deritanishme lidhur me caktimin e një dëmshpërblimi të tillë, kështu që duke pasur kujdes që dëmshpërblimi i caktuar të mos ketë tendenca e synime që janë në kundërshtim me natyrën dhe me qëllimin shoqëror për të cilin me ligj është paraparë një formë e tillë e dëmshpërblimit, Gjykata Supreme e Kosovës caktoi dëmshpërblimin në emër të zvogëlimit të aftësisë së përgjithshme jetësore për 25%, në shumën prej 7.500 €, dhe për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 2 muaj në shumë prej 400 €, e bindur plotësisht se shumatat e tilla për paditësen paraqesin një dëmshpërblim të konsiderueshëm dhe të arsyeshëm për dëmin jo material që ajo ka pësuar në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe për ushqim të përforcuar.

Sa i përket kompensimit të gjykuar nga ana e gjykatës së shkallës së dytë për fitim të humbur në emër të zvogëlimit të aftësisë punuese, Gjykata Supreme gjen se shuma e aprovuar është në kundërshtim me mendimin e konstatimit të ekspertëve mjekësor, të cilin mendim të dy gjykatat e shkallës më të ulët e kanë pranuar si të bazuar. Ky kundërshtim rezulton nga ajo se ekspertiza financiare është në kundërshtim me ekspertizën mjekësore, dhe këto gjykata me pranimin plotësisht si të bazuar të ekspertizës financiare pjesërisht në mënyrë të gabuar kanë zbatuar të drejtën materiale, kjo për arsye se sipas mendimit të ekspertëve dr.T. G., mjeko ligjor , dr.V. B., ortoped-traumatolog dhe dr.F. D., neuropsikiatër, paditësja në 3 muajt e parë pas aksidentit ka pasur zvogëlim të aftësisë punuese 100%, ndërsa në 3 mujorin e dytë ky zvogëlim i aftësisë punuese bie në lartësinë prej 50%, dhe pas 6 muajve tek paditësja zvogëlimi i aftësisë punuese manifestohet në lartësi prej 25%, e cila lartësi edhe mbetet si e përhershme tek paditësja. Në kundërshtim me këtë, eksperti financiar ka përlogaritur pagën e humbur si pasojë e zvogëlimit të aftësisë punuese , si të plotë, jo për 3 muaj siç kanë gjetur këta ekspertë , por për 6 muaj, po ashtu për 6 muaj ka përlogaritur edhe zvogëlimin e aftësisë punuese prej 50%. Për këto arsye dhe me qëllim të përshtatjes mendimit e konstatimit të këtyre ekspertëve mjekësor, e duke gjetur se është jo kontestuese lartësia e pagës prej 300 €, të cilën paditësja e ka realizuar në bazë të marrëdhënies së punës në momentin e aksidentit , Gjykata Supreme u deshtë që të ndryshojë në këtë drejtim aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë dhe të parë duke iu pranuar si fitim i humbur paditëses paga e plotë për 3 muajt e parë , ndërsa për 3 muajt tjerë në vazhdim vetëm

50% e pagës, dhe pas 6 muajve prej ditës së aksidentit vetëm 25% e pagës, nga se zvogëlimi i aftësisë punuese tek paditësja ka ngelur në mënyrë të përhershme në lartësi prej 25%.

Sa i përket vendimit për kamatën , gjykata këtë vendim e bazon në nenin 277 të LMD, duke caktuar fillimin e rrjedhjes së kamatës për fitim të humbur në emër të zvogëlimit të aftësisë punuese , që nga data 01 e çdo muaji vijues për muajin e kaluar, gjer në pagesën definitive, ndërsa për format tjera të dëmshpërblimit kamata e aprovuar nga gjykatat e shkallës më të ulët kanë ngelur të paprekura.

Në mënyrë të veçantë , Gjykata Supreme e Kosovës vlerësoi thëniet e revizionit se ky aksident është inskenuar, dhe si i tillë fare nuk ka ndodhur , dhe se ka manipulime rreth këtij aksidenti , dhe gjeti se pretendimet e tilla janë të pabazuara për arsye se, në njërën anë, me aktgjykimin penal të Gjykatës Komunale në Prishtinë P.nr.2049/2010 datë 28.06.2011, në mënyrë të sigurt vërtetohen faktet dhe rrethanat të cilat revizioni i kundërshton si të paqena, dhe në anën tjetër pretendimet e tilla i përkasin konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike për të cilin shkak në kuptim të nenit 214.2 të LPK, revizioni nuk mund të paraqitet.

Po ashtu objekt vlerësimi ishin edhe pretendimet e revizionit që i përkasin shkeljeve procedurale nga se tre herë në këtë çështje juridike është bërë ekspertiza mjekësore. Pretendimet e tilla u vlerësuan si të pabazuara nga se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të qarta dhe bindëse për një veprim të tillë procedural , për faktin se ekspertiza e dytë mjekësore ka ngelur në kundërshtim me ekspertizën e parë mjekësore , për çka me propozimin e palëve është imponuar proceduralisht që të bëhet edhe një ekspertizë nga ekspertë tjerë , e cila ekspertizë më në fund ka qenë bindëse dhe me arsye e pranueshme nga gjykata e shkallës së parë, kështu që në këtë drejtim nuk mund të flitet me arsye për shkelje procedurale me rastin e nxjerrjes së kësaj prove.

Për arsyet e paraqitura më lart dhe në pajtim me nenin 222 dhe 224.1 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Rev.nr.241/2017 datë 15.11.2017

Kryetar i kolegjit,
Shukri Sylejmani